



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:177350

Datë: 14.10.2024

Numri i dokumentit: 06292413

2021:177351

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.K me vendbanim në Ferizaj, rr. ..., të cilin e përfaqëson av. Jeton Berisha nga Ferizaj kundër të paditurës Komuna Ferizaj, me objekt kontesti kompensimi i dëmit në pronën e paluajtshme, vlera e kontestit e pacaktuar, jashtë seance më datë 14.10.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia me shenjen e paditësit A.K nga Ferizaj kundër të paditurës Komuna Ferizaj, për shkak të ekzistimit të gjyqëvarësisë (litispedencës).

A r s y e t i m

Paditësi A.K përmes të autorizuarit të tij av. Jeton Berisha nga Ferizaj kanë ushtruar padi në këtë gjykatë me dt. 11.08.2021 kundër të paditurës, me bazë juridike kompensimi i dëmit në pronën e paluajtshme, vlera e kontestit e pacaktuar.

Gjykata duke u bazuar në të dhënat e sistemit elektronik për menaxhimin e lëndëve (SMIL) ka gjetur së paditësi A.K me vendbanim në Ferizaj, rr. ..., për çështjen e njëjtë pranë kësaj gjykate kishte ushtruar edhe një padi tjetër më dt. 27.09.2021 së bashku me paditësit tjerë Xh. dhe R.K., kundër të paditurit Komuna Ferizaj, e cila udhëhiqet sipas shenjës ..., me objekt të njëjtë të kontestit, lidhur me pronën e njëjtë (0...1-12 ZK Ferizaj).

Gjykata pasi analizojë të dy paditë me shenjat ... dhe ..., gjeti së bëhet fjalë për çështjen e njëjtë (kompensimi i dëmit në pronën e paluajtshme numër ... ZK Ferizaj, e regjistruar në emër të A.K) dhe meqenëse lënda ... është proceduar dhe është mbajtur shqyrtimi përgatitor më dt. ...,

atëherë gjykata vendosi ta hedhë poshtë padinë në këtë çështje (me shenjë ...), për shkak të litispendencës.

Sipas nenit 262.3 të LPK parashihet që: “Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë.”, kurse sipas nenit 262.4 të LPK, gjykata gjatë gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, kujdeset nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta. Ndërsa sipas nenit 391, pika c) të LPK, përcaktohet se pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: c) për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (litispendenca).

Nga të cekurat më lartë gjykata duke u bazuar në nenin 391, pika c) të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm

2021:177351, datë 14.10.2024

Gj y q t a r i,

Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.